



Nr. prot. 1278 Tiranë 08.08.2024

Nr. prot. 94/08 Prishtinë, 08/08/.2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE – TIRANË

Dhe

**AGJENCISË PËR MENAXHIMIN E MONUMENTEVE DHE KOMPLEKSEVE
MEMORIALE-PRISHTINË**

Sot, më 08/08/ 2024, në Tiranë, është nënshkruar, si më poshtë, Memorandumi i Bashkëpunimit, ndërmjet:

Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, me seli në Tiranë, adresa Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. SOKOL ISMAILI**, në vijim e referuar si “**IKTK**”:

dhe

Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, me seli në Prishtinë, me adresë Rruga “Zenel Salihu”, Ish Gjykata Themelore, Prishtinë, Kati -II- Nr. 202, 10.000 Prishtinë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Z. IMER HAKAJ**, referuar në vijim si “**AMMKM**”.

Me qëllim:

Përmirësimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e restaurimit dhe konservimit të objekteve, të trashëgimisë kulturore, në mënyrë specifike objekteve të cilat kanë shërbyer gjatë luftës së fundit në Kosovë, specifikisht objekteve të cilat Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale ka interes për të restauruar dhe konservuar për ruajtjen dhe promovimin historik të tyre.

Neni 1

Fusha e Bashkëpunimit

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit ndërmjet dy palëve në fushën e konservimit dhe restaurimit të objekteve në mënyrë specifike objekteve të cilat kanë shërbyer gjatë luftës së fundit në Kosovë, për të cilat “AMMKM” ka interes për konservimin dhe restaurimin historik të tyre.

Neni 2

Përmbajtja

“AMMKM” dhe “IKTK”, përmes këtij memorandum bashkëpunimi dhe në frymën e ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe njerëzore zotohen se do të ndërmarrin të gjitha veprimet e mundshme në mënyrë që të realizojnë aktivitetet si më poshtë:

1. Trajnime dhe hulumtime të përbashkëta në restaurim dhe konservim, duke përfshirë ruajtjen, muzealizimin dhe promovimin e objekteve/monumenteve;
2. Shkëmbime profesionale dhe vizita studimore të ekspertëve të restaurimit, ekspertëve të konservimit, me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave profesionale dhe përfitimit të të reja shkencore nga kjo lëmi shkencore;
3. Takime të përbashkëta në fushën e konservimit dhe restaurimit në mes të dy vendeve nënshkruese të kësaj marrëveshje bashkëpunimi;
4. Takime të përbashkëta të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore – Tiranë, me institutet dhe institucionet respektive të shteteve të rajonit dhe shteteve tjera evropiane;
5. Koordinimin e përbashkët me qëllim të përfitimit të mbështetjes financiare dhe ekspertizës nga fondet e Bashkimit Evropian si dhe mekanizmave tjerë që mbështesin restaurimin dhe konservimin e monumenteve dhe aseteve trashëgimore dhe historike;
6. Ofrimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me qëllim të anëtarësimit në organizatat e specializuara për konservim dhe restaurim;
7. Ofrimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me qëllim të pjesëmarrjes në konferenca dhe takime regjionale dhe ndërkombëtare në fushën e konservimit dhe restaurimit;

8. Ofrimin e bashkëpunimit dhe ekspertizës profesionale në fushën e hartimit dhe zbatimit të legjislacionit për konservim dhe restaurim në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Lista e aktiviteteve të sipërcituara, nuk është shteruese.

Neni 3

Përgjegjësitë e palëve nënshkruese

1. Palët nënshkruese janë përgjegjëse që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga neni 2 i këtij memorandumit.
2. Palët nënshkruese koordinohen me të gjitha institucionet kompetente me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në nenin 1 dhe 2.

Neni 4

Personat e kontaktit

1. Secila nga palët nënshkruese do të caktojë një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër.
2. Në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, personat e kontaktit janë si vijon:

Për Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale:

Z. Enver Dreshaj

Pozita: Specialist i Ndërtimtarisë

Spektori: Divizioni për Planifikim, Projekte të Komplekseve

Email: enver.dreshaj@rks-gov.net

Për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore - Tiranë:

Znj. Joli Mitrojorgji

Pozita: Përgjegjëse Sektori

Spektori: Qendra Rajonale e Konservimit dhe Restaurimit për Evropën Juglindore.

Email: joli.mitrojorgji@iktk.gov.al

3. Personat e caktuar sipas këtij neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që do të dalë në zbatim të marrëveshjes.

4. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar sipas këtij neni, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, me të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Të gjitha mosmarrëveshjet eventuale në mes të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, do të zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet palëve nënshkruese.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

1. Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët dhe është i vlefshëm për një periudhë 2 (dy) vjeçare, me mundësi rinovimi edhe për një periudhë tjetër të ngjashme, pas konfirmimit me shkrim nga palët.
2. Ky memorandum mund të ndryshohet në çdo kohë nëpërmjet miratimit të ndërsjellë të Palëve me shkrim.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky memorandum bashkëpunimi nënshkruhet nga palët në Tiranë, më datë 08.08.2024, në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) për palët respektive në memorandum dhe 1 (një) kopje për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.

Z. SOKOL ISMAILI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

“IKTK”



Z. IMER HAKAJ

DREJTORE EKZEKUTIV

“AMMKM”



Tiranë: Qershor 2024